



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 23.05.2022

Më datë 23 Maj u zhvillua mbledhja e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat (KKN). Axhenda i takimit ishte:

1. Miratimi i Planit të Aktiviteteve të KKN për vitin 2022;
2. Plani i Trajnimeve mbi Nomenklaturën e Produkteve sipas Aktiviteteve (NPA 2.1);
3. Prezantim mbi punën e kryer për Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistikore, (ICCS) si dhe
4. Çështje të tjera

Në mbledhjen online ishin prezent 16 anëtarë të KKN.

Zv/Kryetarja e KKN, Znj. Rahela Reçi në mungesë të Kryetares Znj. Elsa Dhuli pasi i uroi mirëseardhjen tre anëtarëve të rinj e quajti mbledhjen të hapur. Pas miratimit të axhendës nga të gjithë anëtarët, mbledhja vijoi sipas rendit të ditës.

Miratimi i planit të aktiviteteve

Znj. Reçi rikujtoi anëtarët se në mbledhjen e fundit të KKN-së për vitin 2021, ju është vënë në dispozicion një draft plan i aktiviteteve të komisionit planifikuar për tu zhvilluar gjatë vitit 2022. Pas mbledhjes së komenteve/sugjerimeve të ardhura nga anëtarët, plani i aktiviteteve është finalizuar nga sekretariati dhe duhet të miratohet nga anëtarët prezent sot në takim.

Plani i aktiviteteve u miratua nga të gjithë anëtarët.

Plani i Trajnimeve mbi Nomenklaturën e Produkteve sipas Aktiviteteve (NPA 2.1)

Në vijim Znj. Flutura Rama informoi anëtarët e rinj mbi klasifikimet e miratuara deri më tani me vendim të këshillit të ministrave si dhe mbi planin e trajnimeve të përgatitur bazuar në nevojat e dërguara nga institucionet të cilat i përdorin klasifikimet në fjalë.

INSTAT gjatë muajit qershor do të organizojë trajnime për zbatimin e NPA 2.1 dhe trajnime për NVE Rev.2.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

INSTAT në rolin e institucionit drejtues të sistemit kombëtar statistikor, ofron mbështetjen metodologjike dhe teknike për çdo trajnim, në kuadër të implementimit të klasifikimeve. Zbatimi korrekt i klasifikimeve dhe prodhimi i statistikave mbështetur në to është kurorëzimi ose finalizimi i tërë punës së Komisionit përgjatë një viti.

Prezantim mbi punën e kryer për Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistikore, (ICCS).

Më tej takimi u fokusua në një çështje mjaft të rëndësishme, në Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistikore, (ICCS). ICCS bazuar në planin e aktiviteteve 2022 është projektuar të kalojë për miratim në gjysmën e dytë të këtij viti.

Znj. Majlinda Nesturi, drejtoreshë e Statistikave Sociale pranë INSTAT bëri një prezantim mbi punën e kryer nga grupi teknik për finalizimin e hartëzimit të 11 kapitujve të klasifikimit ICCS. Ky klasifikim është zhvilluar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC). ICCS është një klasifikim që grupon dhe organizon veprat penale në mënyrë hierarkike, kuptimplotë dhe sistematike. Njësia primare e klasifikimit është vepra ose ngjarja që përbën një vepër penale.

Aktivitetet të përfunduara në bashkëpunim me grupin e punës janë si më poshtë:

- Hartëzimi, diskutimi dhe finalizimi me grupin e punës të 11 niveleve të klasifikimit;
- Vlerësimi i prodhimit aktual të të dhënave në institucionet kryesore pjesë e sistemit të drejtësisë penale;
- Ushtrim për Nivelin 1 të ICCS sipas burimeve, hedhja e të dhënave nga kodi specifik i Kodit Penal te kodi ICCS, identifikimi i problematikave;

Aktivitete në proces:

- Përgatitja e raportit lidhur me zbatimin e klasifikimit në Shqipëri, qasja që do përdoret;
- Diskutime lidhur me afatet për zbatimin e ICCS nga institucionet zbatuese të klasifikimit.

Në fund të takimit Znj. Flutura Rama informoi pjesëmarrësit mbi revizionomin nga Eurostat të klasifikimit NVE Rev.2. Zhvillimet e fundit teknologjike kanë mundësuar shfaqjen e aktiviteteve të reja ekonomike dhe rëndësia e tyre në ekonominë globale, sjell domosdoshmërinë e trajtimit me kujdes dhe vendosjen e një kodi të posaçëm NVE(4 shifor). Të tillë aktivitete janë : shitjet online, trajtimi i mbetjeve nga inceneratorët, transfertat virtuale monetare (criptomonedha).

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Detyrat e lëna nga KKN:

1. Të përgatisë minutat e takimit - Sekretariati i KKN
2. Të miratojë minutat -Anëtarët e KKN;
3. Dërgimi i planit të aktiviteteve (final dokument) - Sekretariati i KKN;
4. Dërgimin e Planit të Trajnimeve - Sekretariati i KKN;
5. Dërgimin e prezantimit të Klasifikimit Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistikore, (ICCS);
6. Dërgimin e 11 kapitujve të hartëzuar të klasifikimit ICCS (material në format excel) - Sekretariati i KKN

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al